

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mbrojtja “fut” ujë, Interi ka 5 ditë kohë për të korrigjuar gabimet para duelit me Romën
ADRESA	https://kohajone.com/sporti/mbrojtja-fut-uje-interi-ka-5-dite-kohe-per-te-korrigjuar-gabimet-para-duelit-me-romen/
BURIMI	kohajone.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 07:02:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 06:57:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	1e17af0cbf69913a829e7b572efc8949fbce773473e5a6e442bd62b023b261e4
TEKSTI	05ae5b9f1a0903ad0859922f1239940ef54a091d247eab7a1d1b27fe2a3bfc00
PAMJA	c2cca060af05f96bb3263bbf4d0f3babca2a104ff4352da455a6142d5bb47581

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	b3648de1bdc10a61d6488bb82111ee0b585aba62b6a39d198d4dc8011c50d4df
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	144dcc84d15b7d80530ccf1620af6bb24eccd27028b717aa2669aa241970dde3
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/b3648de1bdc10a61d6488bb82111ee0b585aba62b6a39d198d4dc8011c50d4df>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px


Mbrojtja “fut” ujë, Interi ka 5 ditë kohë për të korrigjuar gabimet para duelit me Romën

SPORTI E MARTË, 15 SHTATOR 2026 08:57



Interi po përjeton një moment që kërkon reflektim. Mund të quhet mungesë përqendrimi, shpërqendrim apo edhe një dozë e tepruar vetëbesimi, por një fakt është i pamohueshëm: skuadra e Cristian Chivut po pëson shumë gola.

Në tri ndeshjet e fundit, zikaltërit kanë pësuar plot shtatë gola dhe në të tria rastet janë gjendur në disavantazh të dyfishtë, 0-2. Kundër Napolit dhe Udineses, reagimi ishte i fuqishëm dhe solli përmbyshjen, ndërsa ndaj Real Madridit reagimi nuk mjaftoi për të ndryshuar fatin e takimit.



Problemi kryesor duket se lidhet me gabimet individuale dhe kolektive në fazën mbrojtëse. Në Madrid, për shembull, Martinez pati përgjegjësi në golin e Valverdes, ndërsa ndaj Udineses problemet ishin më shumë të natyrës kolektive.



Interi po u lejon kundërshtarëve shumë hapësira, veçanërisht në pjesët e para të ndeshjeve. Chivu ka përdorur rotacion të vazhdueshëm në qendër të mbrojtjes, por deri tani nuk ka gjetur ende kombinimin që i jep skuadrës garancitë maksimale.

Bastoni është shfaqur si mbrojtësi më i qëndrueshëm, ndërsa Akanji ka pasur disa momente pasigurie. Bisceck mbajti përgjegjësi për pjesërisht golin e parë të Realit, ndërsa Stones, i aktivizuar titullar ndaj Udineses, pati vështirësi përballë Davis dhe u largua më pas për shkak të problemeve muskulore.

Megjithatë, nëse mbrojtja është shqetësimi kryesor, sulmi vazhdon të jetë pika më e fortë e skuadrës. Kur Interi arrin të shfaqë të gjithë potencialin e tij ofensiv, kundërshtarët e kanë jashtëzakonisht të vështirë ta ndalin.

Këtë e tregoi edhe ndeshja ndaj Udineses. Lautaro Martinez nuk u aktivizua, me qëllim shmangien e një mbingarkese fizike pas një fillimi shumë intensiv të sezonit. Në vend të tij, golat erdhën nga Thuram, Pio Esposito dhe Bonny, duke konfirmuar thellësinë e madhe që Interi ka në repartin ofensiv.

LAJMET KRYESORE



Sot vendimi i Gjykatës së Lartë/Tirana duhet të drejtohet nga kryetari i zgjedhur



Vuçiç largohet nga Presidenca, por synon të rikthehet si Kryeministër i Serbisë



Me 16 shtator parashikohet mbi 1 milionë qytetarë në Prishtinë. Pritet vendimi i Hagës. Ka dyshime për trazira nëse....



Rama për pagat e gjyqtarëve: Askush nuk e zëvendëson Parlamentin, në 17 shtator mbaron episodi i tensionuar




Tërhiqet Bekim Sejdiu, dështon kandidatura për President: Nuk ka mbështetje të mjaftueshme parlamentare

TË PËRZGJEDHURA



Edmond Spaho te Nikoll Lesi: PD ka mbaruar, nuk vjen ne pushtet!



Luka Modric konfirmon pjesëmarrjen me Kroacinë në Ligën e Kombeve



Dëshirat e Spallettit dhe blerjet e Juventus-it



Tesla, drejtimi gjysmë-autonom drejt përshtatjes me rregullat evropiane, thotë Franca



Shpërthen Erion Braçe te Nikoll Lesi në KOHA JONË-DEBAT: Nuk votoj kandidat me “njoftim”!

MË TË LEXUARAT

Një tjetër pikë që mund të diskutohet është zgjedhja e mesfushës. Përballë një skuadre dinamike si Udinese, aktivizimi i njëkohshëm i Zielinski dhe Mkhitarianit, dy lojtarë në një fazë më të avancuar të karrierës, mund të jetë një element që Chivu duhet ta rishikojë në ndeshjet e ardhshme.

Në fund, pyetja kryesore për Interin është nëse këto probleme vijnë thjesht nga shpërqendrimi apo nga një tepëri vetëbesimi. Mendimi se "jemi Interi dhe në një mënyrë apo tjetër do ta përmbysim" mund të jetë i rrezikshëm.

Në Madrid, përmbysja nuk erdhi. Ndaj Napolit, goli i fitores u shënua vetëm në sekondat e fundit të kohës shtesë. Kjo tregon se Interi nuk mund të mbështetet gjithmonë te reagimet e tij të fuqishme.

Skuadra e Gasperinit është një kundërshtar që nuk fal gabimet dhe që di të shfrytëzojë hapësirat. Mbrojtja e Interit do të përballlet me një presion të madh, ndërsa çdo humbje përqendrimi mund të kushtojë shtrenjtë.

Përballja e 19 shtatorit mund të jetë kështu shumë më tepër se një ndeshje e radhës. Ajo mund të shërbejë si një pikë kthese për Interin dhe për garën për titullin.

MË SHUMË NGA SPORTI



Spalletti në provë te Juventus, pas humbjes bonuset mbaruan. A kthehet...



Seferi nuk ndalet në Turqi, dopietë dhe një mesazh i fortë për Kombët...



Konfirmohet tërheqja e Neymarit nga Brazili



Kategoria e Parë, publikohet formacioni më i mirë i javës së 2-të



Tranjeri i kuqezinjëve, Maran: Ndiheh si në shtëpi, shqiptarët kanë n...



Kur publikohet lista e Kombëtares për Ligën e Kombeve? Maran zbulon m...

LAJMET E FUNDIT



Sot vendimi i Gjykatës së Lartë/Tirana duhet të drejtohet nga kryetari i zgjedhur

[8 MINUTA MË PARË](#)



Spalletti në provë te Juventus, pas humbjes bonuset mbaruan. A kthehet Conte?

[15 MINUTA MË PARË](#)



Rruga e re e Komanit (video)

[21 MINUTA MË PARË](#)



Moti sot. 15 shtator 2026: Diell



Kursi i këmbimit. 15 shtator



Horoskopi për të martën. 15

dhe temperatura deri në 31
gradë

24 MINUTA MË PARË

2026

27 MINUTA MË PARË

shtator 2026

30 MINUTA MË PARË

MË SHUMË LAJME TË FUNDIT >

KOHA JONE

Gazeta "KOHA JONE" themeluar si e pavarur më datë 11 Maj 1991

Botues: Nikoll LESI. Adresa e redaksisë: Rruga "Sami Frasheri", Pallatet e Aviacionit të Vjetër Nr. 2, TIRANA - ALBANIA

TË FUNDIT

LAJME

SPORTI

EKONOMI

EDITORIAL

WEBTV

AKTUALITET

RAJONI

KOSOVA

BOTA

TEKNOLOGJI

SHOWBIZ

SHËNDETI

SOCIALE

TURIZËM

KURIOZITETE

KULTURA

HISTORIKU

KONTAKT

BOTUES & DREJTOR: Nikoll LESI

KRYEREDAKTOR: Daniel MUÇAKU

ZV/KRYEREDAKTOR: Redjon SHTYLLA

BORDI: Elsa KAMBERI, KRYETARE

NIPT: J71425013C



NDËRTUAR DHE MIRËMBAHET NGA

SD

© 2024 KOHA JONE. All rights reserved.

PRIVACY POLICY

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.